


AGJENDA E GJELBËR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE DETYRIMET E KOMUNAVE



Titulli:
AGJENDA E GJELBËR E BALLKANIT PERËNDIMOR
DHE DETYRIMET E KOMUNAVE

Botues:
Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Autor:
Bojana Bozhinovska Siljanovska

Projekti:
Organizatata civile në veprim për klimën
Zbatuesit: Projekti zbatohet nga Qendra për hulumtim dhe in-
formim për mjedisin jetësor “Eko-svest” nga Shkupi, Shoqata
maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e
vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

Redaktimi gjuhësor:
Eleonora Stojkoska-Popetrevska

Përkthim nga gjuha maqedonase
në shqip nga përkthyesi:
Rexhep Xheladini

Dizajni:
PrivatePrint

Shkup, 2023



Проектот “Граѓанските организации во акција за климатските промени” е финансиски поддржан од страна на Шведска. Изразените ставови и мислења се на организациите кои го спроведуваат проектот и нужно не ги одразуваат ставовите и мислењата на владата на Шведска.”

Содержина

5

PËRMBLEDHJE

6

**ÇFARË NËNKUPTOJNË ME OBJEKTIVAT
KRYESORE TË AGJENDËS SË GJELBËR?**

8

**DEKARBONIZIMI:
VEPRIMI KLIMATERIK, ENERGJIA
E GJELBËR DHE TRANSPORTI I
QËNDRUESHËM**

10

EKONOMIA RRETHORE

12

**LUFTA KUNDËR NDOTJES SË:
UJIT, AJRIT DHE TOKËS**

14

**PRODHIM I QËNDRUESHËM
I USHQIMIT DHE MJEDISE RURALE
TË QËNDRUESHME**

16

**BIODIVERSITETI:
MBROJTJA DHE RESTAURIMI I
NATYRËS DHE EKOSISTEMEVE**

PËRMBLEDHJE

- ▶ Ndërsa zonat urbane rriten në madhësi, dendësi dhe popullsi, hapësirat e gjelbra bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për qëndrueshmërinë mjedisore. Megjithatë, proceset e urbanizimit, të kombinuara në shumë raste me ndikimet e ndryshimeve klimatike, ushtrojnë presion në rritje në mbajtjen e bimësisë urbane.
- ▶ Mjediset e qëndrueshme rurale, nga ana tjetër, janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për prodhimin e ushqimit cilësor dhe produkteve të tjera bujqësore e blegtorale.
- ▶ Rajoni ynë është një nga më të rrezikuarit nga pasojat negative të krizës klimatike.
- ▶ Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor ndahet midis rajonit dhe Bashkimit Evropian, pasi u miratua nga Plani Ekonomik dhe Investiv për Ballkanin Perëndimor dhe u mbështet nga liderët në rajon përmes Deklaratës së Sofjes në nëntor 2020.
- ▶ Me dorëzimin e Deklaratës për Agjendën e Gjelbër në vitin 2020, janë marrë zotimet për realizimin e zotimeve nga dokumenti dhe zbatimi do të bëhet në nivel lokal.
- ▶ Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është një plan për neutralitetin klimatik në vitin 2050 dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Agjenda me pesë shtylla është në përputhje me ambiciet e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe mbështetet në reformën urgjente rregullatore dhe investime të rëndësishme.
- ▶ Pesë (5) objektivat kryesore të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor janë si më poshtë: Dekarbonizimi: veprimi i klimaterik, energjia e gjelbër dhe transporti i qëndrueshëm; Ekonomia rrethore; Lufta kundër ndotjes: ujit, ajrit dhe tokës; Prodhim i qëndrueshëm ushqimor dhe mjedise të qëndrueshme rurale; Biodiversiteti: Mbrojtja dhe restaurimi i natyrës dhe ekosistemeve.

ÇFARË NËNKUPTOJNË ME OBJEKTIVAT KRYESORE TË AGJENDËS SË GJELBËR?

1

DEKARBONIZIMI: VEPRIMI I KLIMATERIK, ENERGJIA E GJELBËR DHE TRANSPORTI I QËNDRUESHËM

Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë dhe forcimi i rezistencës ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike;

Harmonizimi me Ligjin e ri të BE-së për Klimën, Skemën e Tregtimit të Emetimeve të BE-së;

Reduktimi i emetimeve të CO2 përmes kuotave dhe mekanizmave për përcaktimin e çmimit të karbonit;

Tranzicioni drejt burimeve më të pastra dhe të rinovueshme të energjisë;

Rritja e kapacitetit hekurudhor duke vendosur mënyra transporti miqësore me mjedisin jetësor, duke përfshirë zonat urbane, si dhe zgjidhje të zgjuara të lëvizshmërisë.

2

EKONOMIA RRETHORE

Tranzicioni në një ekonomi plotësisht rrethore është çelësi për arritjen e një tranzicioni të gjelbër;

Zhvillimi i strategjive për të përmirësuar qëndrueshmërinë e prodhimit të lëndëve të para, parandalimin, reduktimin, riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve duke parë të gjithë ciklin jetësor të produkteve;

Zhvillimi i marrëveshjes rajonale për të parandaluar ndotjen me masë plastike, veçanërisht mbetjet detare.

3

LUFTA KUNDËR NDOTJES SË: UJIT, AJRIT DHE TOKËS

Harmonizimi me standardet e BE-së lidhur me cilësinë e ajrit, menaxhimin e ujit dhe mbetjeve;

Modernizimi i monitorimit të ajrit dhe ujit;

Investimi në menaxhimin e ujërave të zeza;

Promovimi i ripërdorimit të ujit në bujqësi.

4

PRODHIM I QËNDRUESHËM USHQIMOR DHE MJEDISE JETËSORE RURALE TË QËNDRUESHME

Zhvillimi i zonave rurale të qëndrueshme;

Rritja e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit;

Reduktimi i mbetjeve, përmirësimi i harmonizimit me standardet e BE-së për sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve;

Promovimi i bujqësisë ekologjike dhe organike.

5

BIODIVERSITETI: MBROJTJA DHE RESTAURIMI I NATYRËS DHE EKOSISTEMEVE




Mbrojtja e pasurisë së habitateve dhe specieve;

Zhvillimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit për Diversitetin Biologjik në Ballkanin Perëndimor 2030 dhe Planit për Restaurimin e Pyjeve;

Eksplorimi i opsioneve për një Qendër Informacioni për Biodiversitetin e Ballkanit Perëndimor.

1

**DEKARBONIZIMI:
VEPRIMI KLIMATERIK, ENERGJIA
E GJELBËR DHE TRANSPORTI I
QËNDRUESHËM**



Ballkani Perëndimor është një nga rajonet më të prekura në Evropë nga ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe kjo prirje parashikohet të vazhdojë, me vlerësime për rritje të temperaturës prej 1,7 – 4,0 °C dhe madje mbi 5,0 °C deri në fund të shekullit të 21-të, në varësi të përpjekjeve globale për të reduktuar emetimet e gazrave serrë. Prandaj, sipas Marrëveshjes së Komunitetit të Energjisë, deri në fund të vitit 2022, Ballkanit Perëndimor do t'i kërkohet të arrijë objektivat e dekarbonizimit deri në vitin 2030. Për të zhvilluar plane të integruara të energjisë dhe klimës për të ndihmuar tranzicionin larg qymyrit në rajon, dhe BE-ja mbështet Platformën për Rajonet e Qymyrit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor.


Qymyri është ende thelbësor për sektorin e energjisë në Ballkanin Perëndimor. Kërkohet një rritje e prodhimit të energjisë së rinovueshme, efikasitetit energjetik, tranzicionit me karbon të ulët, si dhe performancës së linjës së transmetimit të energjisë për rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, në përputhje me potencialin e rajonit.

Lidhjet rrugore, hekurudhore dhe ujore të brendshme në Ballkanin Perëndimor janë të pazhvilluara për shkak të mungesës së investimeve dhe mirëmbajtjes së dobët. Hekurudhat janë ende shumë të varura nga lëndët djegëse fosile, pasi më shumë se 30% e bërthamës TEN-T dhe afërsisht 50% e rrjeteve gjithëpërfshirëse nuk janë të elektrizuara. Agjenda e Gjelbër është një mundësi për të rimenduar strategjitë e përgjithshme të transportit dhe për të promovuar një rrjet transporti më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm. Kjo përfshin mbështetjen e BE-së për rehabilitimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së re më rezistente dhe të zgjuar të transportit, veçanërisht transportin hekurudhor dhe publik, si dhe zgjidhjet e transportit multimodal të gjelbër.

Në një përpjekje për të rritur qëndrueshmërinë ndaj klimës, BE-ja po mbështet rajonin në menaxhimin e rrezikut nga përmytjet.

2



EKONOMIA RRETHORE



Gjenerimi i mbetjeve në Ballkanin Perëndimor ka ardhur vazhdimisht në rritje gjatë viteve të fundit për shkak të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së konsumit dhe aktualisht është rreth 1000 kg/banor. Edhe pse kjo është ende më e ulët se mesatarja e BE-së prej 1700 kg/banor, normat shumë të ulëta të riciklimit (nën 3%, krahasuar me mesataren e BE-së prej 44%) rezultojnë në një sasi më të lartë mbetjesh për frymë që nuk riciklohen. Gjysma e emetimeve totale të gazeve serrë vijnë nga nxjerrja dhe përpunimi i burimeve. Nuk është e mundur të arrihet objektivi i neutralitetit klimatik pa një kalim në një ekonomi plotësisht rrethore. Plani i ri i veprimit të ekonomisë rrethore është baza e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, udhërrëfyesi i BE-së për neutralitetin klimatik. Një model i ekonomisë rrethore ku vlera dhe burimet mbahen në ekonomi për aq kohë sa të jetë e mundur dhe gjenerimi i mbetjeve minimizohet, redukton presionet mbi burimet natyrore duke nxitur rritjen e qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës. Mund të japë një kontribut vendimtar në dekarbonizimin e ekonomisë. Agjenda e Gjelbër detyron Ballkanin Perëndimor të lëvizë drejt një ekonomie rrethore duke përmirësuar menaxhimin e mbetjeve; rritja e produktivitetit të burimeve; vendosja e mënyrave inovative dhe më efikase të prodhimit dhe konsumit dhe futja e qarkullimit në modelet e biznesit.

3

**LUFTA KUNDËR NDOTJES SË:
UJIT, AJRIT DHE TOKËS**




Ndotja e ajrit në Ballkanin Perëndimor mbetet një nga më të lartat në Evropë dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve. Në përpjekjet për të zbatuar legjislacionin për cilësinë e ajrit, Ballkani Perëndimor duhet të jetë në gjendje të sigurojë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit nëpërmjet një sistemi modern dhe të zgjeruar të monitorimit, menaxhimit dhe raportimit të cilësisë së ajrit, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e planeve për cilësinë e ajrit në mënyrë që të jetë në përputhje me standardet e cilësisë së ajrit në përputhje me Direktivat e Cilësisë së Ajrit të Ambientit.

Detyra kryesore përpara është zbatimi i legjislacionit në lidhje me ujin, i cili kërkon më shumë burime për investime në infrastrukturën ujore dhe në strukturën qeverisëse për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit (monitorim dhe raportim, planifikim, koordinim ndërmjet sektorëve përkatës, kapacitet për vlerësimin e ndikimit, etj.). Më saktësisht, fillimisht mund të prioritizohen investimet në monitorimin e infrastrukturës bazuar në hartimin e nevojave në nivel të pellgut lumor, të ndjekur nga zhvillimi dhe zbatimi i masave të duhura për uljen e presioneve mbi trupat ujorë. Një sfidë unike për lumenjtë e rajonit është gjithashtu rritja e menjëhershme e kapacitetit hidroenergjetik në të gjithë rajonin me katër herë midis 2015 dhe 2017, e cila ka ndikime të rëndësishme mjedisore dhe sociale, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë rajonal. Bashkëpunimi ndërkufitar i ujit është shpesh një çështje e ndjeshme politikisht, veçanërisht kur trupat ujorë tregojnë rënie të nivelit të ujit për shkak të ndryshimeve klimatike dhe nxjerrjes së tepërt ose përkeqësimit të cilësisë së ujit nga lumenjtë.

Luftimi i degradimit të tokës dhe restaurimi i tokës së degraduar përfshin prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit, përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, menaxhimin e karbonit organik të tokës, ruajtjen e ekosistemit dhe restaurimin e tokës, zvogëlimin e shpyllëzimit dhe degradimit dhe uljen e humbjeve dhe mbetjeve të ushqimit.

4

**PRODHIM I QËNDRUESHËM
I USHQIMIT DHE MJEDISE RURALE
TË QËNDRUESHME**




Pavarësisht bazës së pasur të burimeve natyrore, sistemet agro-ushqimore në të gjitha vendet e rajonit përballen me sfida të shumta dhe mbeten të kufizuara nga problemet strukturore të rrënjësura thellë: madhësia mesatare e fermës është disa herë më e vogël se në BE, produktiviteti i punës dhe rendimentet janë shumë të ultë – për shkak të aftësive të pazhvilluara teknologjike dhe shumë familje janë ende të angazhuara në bujqësi për mbijetesë. Një sfidë e përbashkët është që ndërmarrjet e përpunimit të ushqimit të jenë në përputhje me standardet e BE-së. Ndërsa sistemet e prodhimit agro-ushqimor në Ballkanin Perëndimor po transformohen gradualisht, do të jetë e nevojshme të sigurohet që tranzicioni të mos kontribuojë më tej në papunësinë ose shpopullimin e zonave rurale ose në përkeqësimin rural dhe humbjen e biodiversitetit.

BE-ja po kontribuon deri në 500 milionë euro në programet IPARD (IPA Zhvillimi Rural) në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Serbi. Kjo është për të mbështetur agrobiznesin dhe fermat në tranzicionin e tyre të gjelbër dhe digjital, si dhe zbatimin e modeleve më të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit. Në Maqedoninë e Veriut, projekti EU4Prespa mbështet zbatimin e Agjendës së Gjelbër në zonën ndërkufitare të Liqenit të Prespës, duke u fokusuar, ndër të tjera, në gjelbërimin e bujqësisë dhe biznesit lokal, si dhe në biodiversitetin.

5

BIODIVERSITETI: MBROJTJA DHE RESTAURIMI I NATYRËS DHE EKOSISTEMEVE



Përveç sigurimit të ushqimit, ujit të freskët dhe ajrit të pastër, mbrojtjes nga përmytjet dhe stuhitë, natyra zbut fatkeqësitë natyrore, dëmtuesit dhe sëmundjet, kontribuon në rregullimin e klimës, lufton degradimin e tokës dhe përmirëson sigurinë ushqimore. Si një rajon me një pasuri habitatesh dhe speciesh, duke përfshirë një numër speciesh të rëndësishme endemike, Ballkani Perëndimor nuk duhet të bëjë asnjë përpjekje për të mbrojtur biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit, duke përfshirë përputhjen me legjislacionin e BE-së. Shpyllëzimi dhe prerja e paligjshme e pyjeve janë një sfidë e rëndësishme e lidhur. Rritja e zjarreve dramatike në pyje në Ballkanin Perëndimor dhe shfaqja e dëmtuesve dhe sëmundjeve kërkojnë parandalim më të mirë të rrezikut në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe përdorimin e tokës. Ballkani Perëndimor duhet të ndërtojë marrëdhënie të ngushta ndërinstucionale dhe rrjete të sektorit privat mes tyre dhe me shtetet anëtare për të zhvilluar një qeverisje të mirë në sektorin pyjor dhe për të zvogëluar rrezikun e eksporteve të paligjshme të lëndës drusore në BE. Vendet e Ballkanit Perëndimor do të zhvillojnë një strategji afatgjate për të ndaluar humbjen e biodiversitetit, për të mbrojtur dhe rivendosur ekosistemet dhe diversitetin e jashtëzakonshëm biologjik.

PJESË E KOMPETENCAVE TË KOMUNAVE

Çdo komunë ka obligim të kujdeset dhe të përmirësojë mjedisin jetësor, si dhe të marrë masa të ndryshme për mbrojtjen e tij. Konkretisht, në aspektin e masave, komunat si njësi të vetëqeverisjes lokale, por edhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale me kërkesë të Qeverisë marrin masa për mbrojtjen dhe parandalimin e ujit, ajrit, toka, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurma dhe rrezatimi jojonizues.

Çdo komunë duhet të përgatisë një plan veprimi lokal dhe të dorëzojë një raport për mjedisin jetësor.

Komunat duhet të parashikojnë masa dhe aktivitete afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve me interes dhe nën autoritetin e komunës, si dhe të parashikojnë burime për financimin e të njëjtave, dhe veçanërisht për:

- ▶ efikasitetit të energjisë;
- ▶ zbutja dhe përshtatja e ndryshimeve klimatike;
- ▶ mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- ▶ furnizimin me ujë të pijshëm cilësor në sasi të mjaftueshme;
- ▶ mbrojtjen e ujërave nga ndotja, pastrimin e ujërave të zeza, reduktimin progresiv të shkarkimeve të dëmshme dhe eliminimin gradual të shkarkimeve të substancave të rrezikshme në ujëra dhe për të zbutur pasojat e efekteve të dëmshme të ujërave dhe mungesës së ujit; menaxhimin e mbetjeve;
- ▶ mbrojtjen nga zhurmat dhe dridhjet që lindin si rezultat i aktiviteteve dhe aktiviteteve ekonomike dhe të tjera;
- ▶ zhvillimin urban dhe planifikimin hapësinor;
- ▶ zhvillimin e transportit publik lokal dhe trafikut në zonë;
- ▶ rritjen e efikasitetit energjetik;
- ▶ zhvillimin e turizmit ekologjiko-kulturor dhe ndikimin e tij në mjedisin jetësor; mbrojtjen e biodiversitetit;
- ▶ menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- ▶ ngritjen e vetëdijes publike dhe zhvillimin e edukimit për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor;
- ▶ pasojat nga zhvillimi ekonomik në mjedisin jetësor dhe subjektet kompetente për zbatimin e elementeve të veçanta të planit.

ÇFARË MUND TË BËNË KOMUNA?

Republika e Maqedonisë së Veriut nënshkroi Deklaratën për Agjendën e Gjelbër në vitin 2020. Me këtë shteti merr përsipër obligim në nivel kombëtar që t'i realizojë zotimet nga dokumenti dhe zbatimi është kryesisht në nivel lokal. Prandaj, është e nevojshme që komunat t'i marrin seriozisht obligimet dhe detyrat e tyre dhe urgjentisht të marrin masa në përputhje me Agjendën e Gjelbër. Disa nga gjërat që duhet të ndërmarrin janë si më poshtë:

► Respektimi dhe kryerja e detyrimeve dhe kompetencave në përputhje me ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës.

► Përmirësimi i rregullt i kapaciteteve në fushën e mjedisit jetësor.

► Përmirësimi i mbikëqyrjes inspektuese.

► Koordinimi dhe komunikimi me institucionet dhe agjencitë e tjera me përgjegjësi në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

► Ndërmarrja e drejtpërdrejtë e një pjese të obligimeve nga Agjenda e Gjelbër në nivel lokal, në përputhje me planet dhe strategjitë planet e Qeverisë dhe Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale.

► Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit.

► Monitorimi dhe raportimi i situatës në terren dhe gjenerimi i të dhënave me rëndësi për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

► Ndërtimi i partneriteteve strategjike me sektorin joqeveritar.

► Edukimi, përfshirja në proceset e sjelljes së planeve dhe dokumenteve vendore dhe informimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve përmes info qendrave të hapura nëpër komuna.

► Bashkëpunimi rajonal me komunat tjera.

МЗМП:

www.myla.org.mk

Еко-свест:

www.ekosvest.com.mk

CNVP:

www.cnvp-eu.org

